KOMUNIKATË PËR MEDIA

Takim përmbyllës me komunat – Ecuria e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos2024)

21 maj 2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) organizoi një takim përmbyllës me komunat për të diskutuar ecurinë e Regjistrimit të Popullsisë (ReKos2024) pas zgjatjes së datës së ReKos 2024 deri më 24 maj 2024.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësuesit e komunave, anëtërë të Komisioneve Komunale të Regjistrimit (KKR) dhe stafi përgjegjës për Regjistrimin e Popullsisë në ASK.

Në këtë takim u diskutua ecuria e punës në terren për Regjistrimin e Popullsisëdhe u kërkua nga komunat që këto ditë të mbetura të angazhohen që të mos u mbetet asnjë qytetar pa u regjistruar në komunat e tyre..

Gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e komunave vlerësuan se procesi i Regjistrimit të Popullsisë ka ecur mirë, duke falënderuar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional në këtë projekt të rëndësishëm.

Komunat, po ashtu, propozuan që të dhënat që do të dalin nga Regjistrimi i Popullsisë të jenë më të detajuar për komunat e tyre.